



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.04/13 prot

Datë 08.02.2024

V E N D I M
Nr. 157/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.02.2024 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-89767-12-05-2023, me objekt: “*Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj)*”, me fond limit 1,771,785 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datën 18.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

Ankimues: Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, me NIPT (J72124001N), me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km.10, Kashar, Rruga “Iliria”, Nr.53, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Albpetrol SHA, me adresë: Rruga “Fier – Patos”, Km 7

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK, me NIPT (L82729403H), me adresë: Zharëz, Frashër, Fshati Frashër, Godina 1 katëshe, Zona Kadastrale nr. 1638, Nr. Pasurie 57/7, Patos, Fier

Operatori ekonomik “Ervin Luzi” PF, me NIPT (K71707007Q), me adresë: Lagjja “Katund i Ri”, Rruga “Ali Pashë Gucia”, Godina Nr.5, Yrshek, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të,

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.12.2023, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik SPE, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-89767-12-05-2023, me objekt: “Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj)”, me fond limit 1,771,785 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 18.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 20.12.2023, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Atlantik 3” ShPK	1,381,500 lekë	skualifikuar
2. “Ervin Luzi” PF	1,389,800 lekë	kualifikuar
3. “Bregu Company” ShPK	1,715,500 lekë	kualifikuar
4. “Marketing & Distribution” ShPK	1,717,790 lekë	kualifikuar

II.3. Në datën 26.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimi i Fituesit Paraparak në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.4. Në datën 03.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokoli 04, datë 03.01.2024, e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit. Gjithashtu, nga informacioni i dorëzuar nga autoritetit kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues, konstatohet, se ankesa është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 03.01.2024.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 04/2 prot., datë 04.01.2024, u publikuan kriteret e kualifikimi, të cilat operatori ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK pretendon, se nuk plotësohen nga operatorët ekonomikë “Bregu Company” SHPK dhe “Ervin Luzi” PF.

II.6. Në datën 08.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik, me anë të formularit të paraqitjes së argumenteve, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.04/3 prot., operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “Bregu Company” SHPK, ka paraqitur argumente për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.7. Me shkresën nr. 43/3 prot., datë 11.01.2024, protokolluar me tonën me nr.04/4 prot., datë 15.01.2024, me objekt *“Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik ‘Marketing & Distribution’” ShPK për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale sanitare (detergjentë, pastrues e.t.j)” me numër reference REF-89767-12-05-2023”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, ku konstatohet, se kjo e fundit është pranuar për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Bregu Company” SHPK dhe “Ervin Luzi” PF.

Konkretisht, referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit, me anë të vendimit nr. nr.43/2 prot., datë 10.01.2024, ka vendosur:

“[...]”

Për sa më sipër, KSHA vlerëson se operatori ekonomik “Ervin Luzi” ShPK si dhe “Bregu Company” ShPK, nuk plotësojnë kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktor në DST dhe nuk përmbush kriteret ligjore të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar. Për këto arsye: [...] Vendosi

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK në tenderin me objekt “Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj.)”, me REF-89767-12-05-2023.*
- 2. Ky vendim i komunikohet titullarit të AK, shoqëria “Albpetrol” ShA.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i njoftohet OE ankimues dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”*

II.8. Në datën 19.01.2024, nëpërmjet shkresës nr.04/5 prot., me objekt: “Kërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor, që “Me shkresën nr. 43/3 prot., datë 11.01.2024, protokolluar me tonën me nr.04/4 prot., datë 15.01.2024, me objekt “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj.)” me numër reference REF-89767-12-05-2023””, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, ku konstatohet se kjo e fundit është pranuar për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Bregu Company” SHPK dhe “Ervin Luzi” PF.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të operatorit ekonomik të interesuar, bazuar në nenin 113 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kërkojmë të na informoni për sa më poshtë:

- 1. A ka paraqitur argumente pranë autoritetit tuaj kontraktor operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK?*
- 2. A e keni njoftuar operatorin ekonomik “Bregu Company” SHPK mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK?*

Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, duhet të dërgoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar, brenda dy ditësh nga marrja e kësaj shkrese.”

II.9. Me shkresën nr. 550/1 prot, datë 25.01.2024, me objekt: “Dërgim informacioni”, protokolluar me tonën me nr. 04/6 prot datë 29.01.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa nr.43/6 prot., datë 11.01.2024, e autoritetit kontraktor, me objekt “Dërgim vendimi si operator ekonomik i interesuar, mbi ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj.)”, me numër reference REF-89767-12-05-2023”, në lidhje me shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar plotësisht ankesën e tij. Gjithashtu, bashkëlidhur shkresës së mësipërme, konstatohet,

se autotoriteti kontraktor ka dorëzuar “printscreen” të email-it, në adresën e deklaruar nga operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK abiolahoxha11@gmail.com, të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, në datë 11.01.2024.

II.10. Nga verifikimi i informacionit të autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk pasqyrohej se në cilën datë është protokolluar pranë autoritetit kontraktor, ankesa e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK. Kështu që, në datën 31.01.2024 nëpërmjet shkresës nr.04/7 prot., me objekt: “Kërkesë për paraqitje provash”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor, informacion si më poshtë: “[...] Nga verifikimi i informacionit të mësipërm, konstatohet se, nuk pasqyrohet se në cilën datë është protokolluar pranë autoritetit tuaj kontraktor, ankesa e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK. Sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm të kërkojë nga ana juaj paraqitjen e dokumentacionit provues që vërteton datën e protokollimit pranë autoritetit tuaj kontraktor, të ankesës së operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të paraqisni dokumentacionin e nevojshëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda ditës së nesërme të punës nga marrja dijani e kësaj shkrese.”

II.11. Gjithashtu, në datën 31.01.2024, nëpërmjet shkresës nr.04/8 prot., me objekt: “Kërkesë për paraqitje provash”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, të provojë si më poshtë: “[...] Sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur nga ana juaj, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshme të kërkojë nga ana juaj paraqitjen e dokumentacionit provues që vërteton datën e dorëzimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor.

Sqarojmë, se bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, ku përcaktohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj” Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj të paraqisni dokumentacionin e nevojshëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja dijani e kësaj shkrese.”

II.12. Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, me anë të shkresës prot.nr. 5071201837, datë 05.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 04.09 prot., datë 05.02.2024, informon se:

“[...] Në lidhje me datën e dorëzimit të objekteve postare pranë institucioneve përkatëse, ju bëjmë me dije se ankesat janë dorëzuar më datë 03.01.2024 (datë brenda afatit shtatë ditor kjo bazuar në nenin 110 pika 8, e cila sanksionon se [...], pranë autoritetit kontraktor, Albpetrol ShA si dhe Komisionit të Prokurimit Publik, kjo vërtetuar sipas fotove të mëposhtme të marra nga site zyrtar i Postës Shqiptare ShA”. Gjithashtu, operatori ekonomik bashkëlidhur shkresës ka paraqitur foto të dëftesave postare, pranimi objekti - postar, për

dorëzimin e ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ku evidentohen Barkodet përkatëse për gjurmimin e dorëzimit të dërgesës.

II.13. Me shkresën nr. 722/1 prot., datë 05.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 04/10 prot., datë 07.02.2024, me objekt “Kthim - përgjigje kërkesës për paraqitje provash”, autoriteti kontraktor informon, se konkretisht citoj:

“[...] bashkëlidhur gjeni:

- *Fotokopje të kartelës shoqëruese të praktikës, të ankesës së OE “Marketing & Distribution” ShPK, sëbashku me ankesën e tij, protokolluar pranë AK me nr. 43 prot., datë 03.01.2024.”*

Gjithashtu, autoriteti kontraktor, i ka bashkëlidhur shkresës së mësipërme, dokumentacionin e sipërcituar, ku evidentohet, se ankesa është protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr.43, datë 03.01.2024.

II.14. Në datën 08.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektrik, me anë të formularit të paraqitjes së argumenteve, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.04/3 prot., operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “Bregu Company” SHPK, ka paraqitur argumente për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.15. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekti i interesuar “Ervin Luzi” PF, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik të interesuar,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Së pari, nga verifikimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, u konstatua se ankesa e këtij të fundit është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, brenda afateve të parashikuara në nenin 110 të Ligjit të Prokurimit Publik.

III.1.2. Së dyti, me shkresën nr. 43/3 prot., datë 11.01.2024, protokolluar me tonën me nr.04/4 prot., datë 15.01.2024, me objekt “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj.)” me numër reference REF-89767-12-05-2023”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i

autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, ku konstatohet, se kjo e fundit është pranuar për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Bregu Company” SHPK dhe “Ervin Luzi” PF.

Konkretisht, referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit, me anë të vendimit nr. nr.43/2 prot., datë 10.01.2024, ka vendosur:

“[...]

Për sa më sipër, KSHA vlerëson se operatori ekonomik “Ervin Luzi” ShPK si dhe “Bregu Company” ShPK, nuk plotësojnë kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktor në DST dhe nuk përmbush kriteret ligjore të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar. Për këto arsye: [...] Vendosi

4. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK në tenderin me objekt “Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj.)”, me REF-89767-12-05-2023.*
5. *Ky vendim i komunikohet titullarit të AK, shoqëria “Albpetrol” ShA.*
6. *Kopje e këtij vendimi i njoftohet OE ankimues dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”*

III.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. *Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të

interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Pra sa më sipër, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Bregu Company” SHPK dhe “Ervin Luzi” SHPK.

III.1.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “Ervin Luzi” nuk ka paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115 pika a/ii të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.2. Lidhur me argumentet e paraqitura nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, nga operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK, respektivisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, argumente për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Me shkresën nr. 43/3 prot., datë 11.01.2024, protokolluar me tonën me nr.04/4 prot., datë 15.01.2024, me objekt “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj.)” me numër reference REF-89767-12-05-2023”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit tuaj kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, ku konstatohet, se kjo e fundit është pranuar për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Bregu Company” SHPK dhe “Ervin Luzi” PF.

Konkretisht, referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit me anë të vendimit nr. nr.43/2 prot., datë 10.01.2024, ka vendosur:

“[...]”

Për sa më sipër, KSHA vlerëson se operatori ekonomik “Ervin Luzi” ShPK si dhe “Bregu Company” ShPK, nuk plotësojnë kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktor në DST dhe nuk përmbush kriteret ligjore të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar. Për këto arsye: [...] Vendosi

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK në tenderin me objekt “Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj.)”, me REF-89767-12-05-2023.

2. Ky vendim i komunikohet titullarit të AK, shoqëria “Albpetrol” sha.

Kopje e këtij vendimi i njoftohet OE ankimues dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.2.2. Në nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga

ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”

III.2.3. Ndërsa në nenin 114 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.2.4. Në nenin 120 pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“2. Me paraqitjen e ankesës, operatori/ët ekonomikë të interesuar, i cili/të cilët nuk është/janë dakord me vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor, detyrohet/detyrohen të paguajë/ paguajnë tarifën e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.2.5. Në nenin 99 pika 3 dhe pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

“3. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e argumenteve, sipas pikës 1, të këtij neni, është 7 (shtatë) ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, ky afat është 5 (pesë) ditë.

4. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar, nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të kësaj pike, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”

Ndërsa në nenin 100 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 4 dhe 5, parashikohet:

“4. Autoriteti/enti kontraktor merr vendim, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 114, të LPP-së, dhe vë në dijeni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. *Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4, të këtij neni.*”

III.2.6. Sa më sipër, nisur nga argumentet e operatorit ekonomik “Bregu Company” SHPK, vlen të sqarojmë, se për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, në datën 03.01.2024, është paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, i cili kundërshtonte kualifikimin e operatorit ekonomik “Bregu Company” SHPK dhe “Ervin Luzi” PF.

Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) *ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit*, si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 04/2 prot., datë 04.01.2024, u publikuan kriteret e kualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimes “Marketing & Distribution” SHPK pretendon se nuk plotësohen nga operatorët ekonomikë “Bregu Company” SHPK dhe “Ervin Luzi” PF..

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 të Ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” operatori ekonomik i interesuar “Bregu Company” SHPK, i cili preket nga ankesa e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, në datën 08.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik, me anë të formularit të paraqitjes së argumenteve, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.04/3 prot. datë 08.01.2024, ka paraqitur argumente në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.

Sa më sipër, sqarojmë, se referuar dispozitave ligjore të mësipërme, afati për paraqitjen e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar, për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, është 5 (pesë) ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, afat ky i cili është respektuar nga operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK si subjekt i interesuar në këtë procedurë prokurimi.

Referuar nenit 113 pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi. Në rastin konkret, duke qenë se operatori ekonomik i interesuar “Bregu Company” SHPK ka paraqitur argumente në përputhje me nenin 113 pika 1, ky i fundit mund të ushtronte të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë nga autoriteti kontraktor, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK. Për sa kohë operatori ekonomik i interesuar “Bregu Company” SHPK ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, vetëm argumente në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK dhe jo ankim në lidhje me vendimin e marrë nga autoriteti kontraktor pas shqyrtimit të ankesës së ankimuesit, ku ka vendosur pranimin e saj, KPP me qëllim gjykimin sa më të drejtë të të gjitha rrethanave dhe fakteve, i kërkoi autoritetit kontraktor informacion në lidhje me hapat proceduralë të ndërmarra prej tij.

Konkretisht, më anë të shkresës nëpërmjet shkresës nr.04/5 prot., datë 19.01.2024, me objekt: “*Kërkesë për informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor, paraqitjen e informacionit si dhe të të gjitha fakteve dhe provave, nëse ky i fundit e ka vënë

në dijëni operatorin ekonomik të interesuar për vendimin e marrë, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 550/1 prot, datë 25.01.2024 me objekt: “Dërgim informacioni”, protokolluar me tonën me nr. 04/6 prot datë 29.01.2024, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr.43/6 prot., datë 11.01.2024, me objekt “Dërgim vendimi si operator ekonomik i interesuar, mbi ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj.)”, me numër reference REF-89767-12-05-2023”, në lidhje me shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar plotësisht ankesën e tij. Gjithashtu, bashkëlidhur shkresës së mësipërme, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka dorëzuar “printscreen” të email-it, në adresën e deklaruar nga operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK abiolahoxha11@gmail.com, të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, në datë 11.01.2024.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit deklaron, se në datën 11.01.2024, ka njoftuar nëpërmjet adresës së emailit, operatorin ekonomik “Bregu Company” SHPK, në lidhje me vendimin e KSHA për pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK. Nga verifikimi konstatohet, se emaili është dërguar nga autoriteti kontraktor në adresën e emailit të operatorit ekonomik “Bregu Company” SHPK, sipas adresës së deklaruar nga vetë ky operator ekonomik në Formularin e Paraqitjes së Argumentave dhe në Sistemin Elektronik të Ankesave.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se nga ana e operatorit ekonomik “Bregu Company” SHPK, janë paraqitur pretendimet në përputhje me nenin 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, por në referim të nenit 114, e konkretisht pikës 5 dhe 6 të tij në të cilin parashikohet shprehimisht se: “[...]5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik. [...]”, operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK nuk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, brenda afatit ligjor, në lidhje me argumentet e paraqitura pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK, nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit brenda afateve të parashikuara në nenin 114, pika 5, të ligjit për prokurimin publik.

Në përfundim, pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, si dhe informacionit të paraqitur nga vetë operatori ekonomik i interesuar “Bregu Company” SHPK, KPP në zbatim të nenit 115 pika 3/b) të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku citohet “3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të

nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”, vendos të mbyllë çështjen në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, për sa kohë autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e tij dhe operatori ekonomik i interesuar “Bregu Company” SHPK, i cili ka paraqitur argumente, nuk ka paraqitur ankim në zbatim të nenit 114 pika 5, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 pika 1 dhe 3, 118 dhe 131 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Ligjit nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-89767-12-05-2023, me objekt: “Blerje materiale sanitare (detergjente, pastrues etj.)”, me fond limit 1,771,785 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datën 18.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Autoriteti Kontraktor të skualifikojë operatorët ekonomikë “Bregu Company” SHPK dhe “Ervin Luzi” SHPK, sipas Vendimit nr.43/2 prot., datë 10.01.2024, të autoritetit kontraktor.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

